

Formati MARC: të kuptuarit e njësive bibliografike

Titulli i originalit:

Understanding MARC Bibliographic

Written by Betty Furrie in conjunction with the Data Base Development
Department of The Follett Software Company

Published by the Cataloging Distribution Service, Library of Congress, in col-
laboration with The Follett Software Company

© 2003 The Library of Congress, except within the U.S.A.

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:

Dr. Sali Bashota

Përkthyes:

Besim J. Kokollari

Redaktor:

Fazli Gajraku

Dizajni dhe realizimi kompjuterik:

Hekuran Rexhepi

© në shqip Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Botime të veçanta: Formati MARC; (vendose numrin)

Formati MARC: të kuptuarit e njësive bibliografike

Përktheu
Besim J. Kokollari

Prishtinë
2007

PËRMBAJTJA

Ç'është njësia në formatin MARC dhe pse është e rëndësishme?	7
Pjesa I: Çka nënkuptojmë me formatin MARC?	8
Pjesa II: Pse na duhen njësitë në formatin MARC?	9
Pjesa III: Terminologjia e formatit MARC dhe definicionet e tyre	12
Pjesa IV: Ku e kanë zanfillën njësitë në formatin MARC?	20
Pjesa V: Çështje lidhur me të dhënat në formatin MARC	23
Pjesa VI: Përfundim	24
Materiale shitesë për formatin MARC	25
Pjesa VII: Përmbledhje e fushave që përdoren më së shpeshti në formatin MARC 21	25
Pjesa VIII: Listë e fushave të tjera të cilat i hasim shpesh në njësitë bibliografike në formatin MARC	33
Pjesa IX: Numri udhëheqës	34
Pjesa X: Fusha 008 për libra	36
Pjesa XI: Një shembull njësie bibliografike në formate të ndryshme	39
Pjesa XII: Njësi audiovizuale: nga skedat në MARC 21	43
Bibliografi e përzgjedhur	49
Botime të përzgjedhura të Shërbimit për Katalogim dhe Shpërndarje të Bibliotekës së Kongresit	49
Treguesit e përmbajtjes në formatin MARC 21: Përsëritje	51
Përgjigjet për treguesit e përmbajtjes në formatin MARC 21: përsëritje	52

Ky libër është për nevoja arsimore në fushën e bibliotekarisë

FORMATI MARC: TÀ KUPTUARIT E NJËSIVE BIBLIOGRAFIKE

Ç'është njësia në formatin MARC dhe pse është e rëndësishme?

Sot është e pamundur që të lexohet një revistë biblioteke, të marrësh pjesë në një konferencë për biblioteka, apo edhe vetëm të kesh një bisedë të zakonshme me kolegët e tjerë bibliotekarë dhe të mos dëgjosh shprehjet “formati MARC”, apo dhe “përputhshmëria e formatit MARC me formatet e tjera”. Në shumë biblioteka nuk ka pasur ende mundësi personeli i tyre të ndjekë kurse të rregullta, në të cilat do të mësonin për tema të rëndësishme të automatizimit të bibliotekave dhe rolin e formatit MARC (lexo: mark) në këtë proces, pasi dihet që sistemet e automatizuara janë pjesë e rëndësishme në biblioteka.

Ky dokument do të shpjegojë – sa më thjesht që është e mundur – kuptimin se çfarë është një njësi në formatin MARC, si dhe do të japë informacione themelore për ta kuptuar dhe vlerësuar një njësi në formatin MARC.

———— Formati MARC ————
të kuptuarit e njësive bibliografike

=====

PJESA I

«KA NËNKUPTOJMË ME FORMATIN MARC?»

Ç'është njësia në formatin MARC?
Me njësi në formatin MARC nënkuptojmë njësi kataloguese të lexueshme nga makina – kompjuteri (ang: *Machine Readable Cataloging Record*).

Atëherë çfarë nënkuptojmë me njësi kataloguese të lexueshme nga makina?

Të lexueshëm nga makina (kompjuteri): Me “të lexueshëm nga makina” nënkuptojmë se një lloj i makinës, për shembull kompjuteri, mund t'i lexojë dhe interpretojë elementet të cilat i vejmë në një njësi të katalogimit. Në faqet në vijim do të japim shpjegime se ku qëndron rëndësia e kësaj dhe si është e mundur një gjë e tillë.

Njësi kataloguese: Me “njësi kataloguese” nënkuptojmë njësinë bibliografike, apo edhe informacionin tradicional të vënë në skeda. Njësi bibliografike përfshin, jo detyrimisht me një strukturë të caktuar, elementet si vijon: 1) një përshkrim të njësisë, 2) përcaktuesen kryesore dhe përcaktueset shtesë, 3) përcaktueset lëndore, dhe 4) numrin e klasifikimit. (Njësitë në formatin MARC kanë zakonisht edhe informacione të tjera shtesë).

1) *Përshkrimi*: Bibliotekarët i ndjekin rregullat anglo-amerikane të katalogimit, botimi i 2-të i vitit 2002 (AACR2), për të bërë përshkrimin bibliografik të njësive bibliotekare. Ky “përshkrim” paraqitet në fushat e ndryshme të një skede. Ajo përfshin titullin, pjesën e personave përgjegjës për botimin, ribotimin, hollësitë për specifikat e materialit, informacione për botimin, përshkrimin fizik, vërejtjet dhe numrat standard.

2) *Përcaktuesja kryesore dhe përcaktueset shtesë*: AACR2, po ashtu, përmban rregulla të cilat i përcaktojnë “pikat e qasjes” (përcaktueset) në një njësi (të cilat shpesh i quajmë “përcaktuese kryesore” dhe “përcaktuese të tjera shtesë”), dhe formën që këto përcaktuese duhet të marrin. Këto përcaktuese përcaktojnë mënyrën se si përdoruesi mund të nxjerrë informacionin duke kërkuar katalogun e një biblioteke.

Me fjalë të tjera, rregullat në AACR2 përdoren për t'u gjetur përgjigje pyetjeve, si: për një libër të caktuar, a duhet të ketë përcaktuese në katalog për një apo më shumë autorë apo për një a më shumë tituj? A duhet të shënohet titulli i koleksionit (serisë)? Si duhet të përshkruhet emri i autorit? A është vetë titulli përcaktuese kryesore në këtë rast (nëse nuk ka autor)?

3) *Përcaktueset lëndore (përcaktueset shtesë lëndore)*: Bibliotekari përdor

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

Listën e përcaktueseve lëndorë Sears, Përcaktueset lëndore të Bibliotekës së Kongresit, si dhe lista të tjera standarde për të përzgjedhur një përcaktuese nën të cilën do të vendoset njësia kataloguese. Përdorimi i një liste zyrtare dhe të miratuar për përdorim ka rëndësi të madhe për standardizim, dhe për të siguruar që të gjitha njësitë kataloguese në një lëmi të caktuar të gjenden nën përcaktuesen e njëjtë dhe po ashtu në vendin e njëjtë në katalog.

Për shembull, lista e përcaktueseve lëndore tregon se të gjitha librat, të cilat bëjnë fjalë për gurët e çmuar, t'u përcaktohet përcaktuesja lëndore "Gurët e çmuar". Duke përdorur këtë përcaktuese të autorizuar, eliminohet mundësia që disa libra të radhiten nën përcaktuesen "Gurët e çmuar" e disa nën përcaktuesen "Xhevahiret". Edhe nëse një libër titullohet "Informacione të përgjithshme për xhevahiret", libri përsëri do të radhitet nën përcaktuesen "Gurët e çmuar". Në këtë mënyrë, të gjitha librat në një lëndë të caktuar do të radhiten në një vend në katalog, kështu që përdoruesi do të mund t'i gjejë me lehtësi. Përdoruesi nuk do të ketë nevojë që të mendojë gjatë dhe të imagjinojë se cilat janë sinonimet e fjalës të cilën ai dëshiron ta kërkojë.

4) *Numri i klasifikimit*: Bibliotekari përdor tabelën e klasifikimit sipas Djuit apo atë të Bibliotekës së Kongresit për të përzgjedhur numrin e

klasifikimit për njësinë kataloguese. Qëllimi i numrit të klasifikimit është që t'i vendosë njësitë e një lënde të caktuar së bashku, afër njëra-tjetrës, në një raft të bibliotekës. Shumica e njësive pastaj nënradhiten në mënyrë alfabetike sipas autorit. Pjesa e dytë e numrit të klasifikimit paraqet emrin autorit, duke ndihmuar në këtë nënradhitje.

PJESA II

Pse na duhen njësitë në formatin MARC?

Pse kompjuteri nuk mund t'i lexojë njësitë bibliografike të krijuara në skeda? Informacioni i njësive të krijuara në skeda prej letre nuk mund të futet thjesht në kompjuter dhe të bëhet menjëherë pjesë e katalogut të automatizuar. Kompjuteri ka nevojë për metoda dhe mënyra me anë të të cilave i interpreton informacionet që gjenden në një skedë prej letre të një njësie kataloguese. Njësitë në formatin MARC përmbajnë një udhërrëfyes të interpretimit të të dhënave të krijuar në të, të njohura si "shenja orientuese", para secilës pjesë (element) të informacioneve të një njësie bibliografike.

Vendi në të cilën vendoset secila pjesë e njësisë bibliografike (autori, titulli, numri i klasifikimit, etj.) quhet "fushë". Struktura e njësive në for-

———— Formati MARC ———— të kuptuarit e njësive bibliografike

matin MARC përmban nganjëherë një numër të fushave me gjatësi të kufizuar dhe kështu ato fusha përmbajnë një numër të kufizuar të karaktereve.

Megjithatë, për të mundësuar një katalogim ashtu si duhet të librave dhe njësive të tjera bibliotekare, struktura e njësive bibliografike mundëson një numër të pakufizuar të fushave dhe të gjatësive të tyre. Ky fleksibilitet është i nevojshëm pasi jo të gjithë titujt janë të një gjatësie të njëjtë (*Kështjella kundrejt Historia e letërsisë botërore*). Madje disa libra janë edhe pjesë e një koleksioni apo serie, të cilat kërkojnë të kenë një fushë, e cila do të përmbajë atë informacion, ndërsa të tjerat nuk kanë nevojë për një informacion të tillë. Për më tepër, materialet audiovizuale e kanë më të gjatë përshkrimin fizik (5 filma: sd., me ngjyra; 35 mm. + doracakun) se sa shumica e librave (403 f. : me ilustr. ; 22 cm.).

Kompjuteri nuk mund të hamendë se një lloj i caktuar i informacionit fillon dhe mbaron në një pozitë të njëjtë në çdo njësi bibliografike. Për shembull, fusha e personave përgjegjës nuk fillon gjithmonë në pozitën e 145-të të një njësie bibliografike dhe të mbarojë në pozitën e 270-të. Prandaj, secila njësi në formatin MARC përmban një "pasqyrë të vogël të përmbajtjes" të formuluar në bazë të standardeve të përcaktuara.

"Shenjat orientuese" të informacioneve: Kompjuterit duhet t'i ofrohet

ndihmë, nëse dëshirojmë që ai t'i lexojë dhe interpretojë si duhet njësitë bibliografike të krijuara në formatin MARC. Tabela e mëposhtme e tregon informacionin që duhet ta bartin këto "shenja orientuese".

Po qe se një njësi bibliografike është krijuar si duhet dhe është ruajtur në kompjuter, atëherë mund të krijohen dhe shkruhen programe kompjuterike, të cilat mund ta shfaqin informacionin ashtu si duhet në ekran të kompjuterit apo edhe të shtypin skeda prej letre. Po ashtu, mund të krijohen programe të ndryshme, të cilat do të mundësojnë kërkimin dhe nxjerrjen e rezultateve për lloje të caktuara të informacioneve brenda fushave specifike. Programet kompjuterike mund të shfaqin po ashtu edhe lista të njësive të caktuara, të cilat përmbushin kriteret e caktuara të një kërkimi të veçantë.

Krahasimi i njësive së njëjtë, ku paraqitet me tekst dhe me tage në formatin MARC, paraqet një shembull të mirë të përparësive të formatit MARC 21. Këtu kemi të bëjmë me hapësirën që zënë këto informacione në bazën e të dhënave të bibliotekës. Shih tabelat më lart. Formati MARC 21 përdor taget "260" "5a" "5b" dhe "5c" për t'i dalluar fushat veç e veç në vend të ruajtjes së fjalëve "fusha e botimit", "vendi i botimit", "emri i botuesit" dhe "data e botimit" për secilën njësi bibliografike. Ky standard mundëson përdorimin më efikas të kompjuterëve, duke kursyer sa më shumë hapësirë në të.

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

Pse një standard? Ju mund të krijoni metodat tuaja të organizimit të informacioneve të njësive bibliografike, por në atë mënyrë do ta izoloni bibliotekën tuaj, do t'i kufizoni mundësitë, dhe do t'i krijoni vetes suaj shumë më shumë punë. Duke e përdorur formatin standard MARC, ju parandaloni kryerjen e një pune dy herë dhe u mundësoni bibliotekave që t'i përdorin informacionet e njëjta të njësive bibliografike mes tyre, pa pasur nevojë që ato të përshkruhen sërish. Përzgjedhja e formatit MARC u mundëson bibliotekave të marrin dhe përdorin informacionet e njësive bibliografike, të cilat janë të parashikueshme dhe të besueshme. Po qe se një bibliotekë do të zhvillonte një sistem "të vetin", që nuk do të përdorte njësitet në formatin MARC, nuk do të paraqiste ndonjë përparësi apo përparim në fushën e industrisë së standardeve, qëllimi i të cilave është komunikimi i informacioneve sa më gjerë që të jetë e mundur.

Përdorimi i formatit MARC u bënë të mundur bibliotekave që të shfrytëzoheshin sistemet e automatizuara bibliotekare, të cilat shërbejnë për menaxhimin e veprimtarisë bibliotekare. Shumica e sistemeve të tilla u përshtatën nevojave të çdo lloji bibliotekë dhe janë të projektuara në atë mënyrë që të punojnë me formatin MARC. Këto sisteme mirëmbahen nga shitës të ndryshëm komercial, kështu që bibliotekat mund të përfitojnë nga teknologjia e fundit. Formatin standard

Njësi pa tage në formë teksti

"Shenjat orientuese"	Informacioni
Përcaktuesja kryesore, emri personal me vetëm një mbiemër	Anronsky, Jim.
Fusha e titullit dhe e personave përgjegjës, përzgjedh vetëm informacionin e titullit si përcaktues shtesë të titullit "Ra..." Informacioni i titullit:	Raccoons and ripe corn/ Jim Arnosky.
Personat përgjegjës:	
Fusha e ribotimit: Informacioni për ribotim:	Botimi 1.
Fusha e botimi, e shpërndarjes, etj.: Vendi i botimit:	New York : Lathrop, Lee & Shepard Books, C1987.
Data e botimit:	
Fusha e përshkrimit fizik: Faqet: Ilustrimet: Madhësia	25 f. : ilustr. me ngjyra : 26 cm.
Fusha e vërejtjeve: Përmbledhja:	Rakunët e uritur festojnë natën në fushën me misër të pjekur.
Përcaktueset shtesë lëndore, nga lista e përcaktuesve lëndorë për fëmijë të Bibliotekës së Kongresit: Përcaktues tematike:	Rakunët.
Numër lokal i klasifikimit:	599.74 ARN
Numër lokal i barkodit	8009
Çmimi:	\$15.00

në MARC po ashtu mundëson që bibliotekat të mund të zëvendësojnë një sistem me një tjetër duke garantuar që informacionet e ruajtura në këtë format të përputhen përsëri me sistemin e ri.

MARC 21: Për shkak se Biblioteka e Kongresit ka koleksione të mëdha, si dhe programe bashkëpunimi me bibliotekat të tjera, formati MARC21 shërben si burim kryesor i njësive bibliografike për katalogët në ShBA dhe në nivel ndërkombëtar. Në kohën kur Biblioteka e Kongresit filloi të përdorte kompjuterë në vitet e 1960-ta, ajo shpiku formatin bibliografik në MARC të Bibliotekës së Kongresit, sistem që përdorte numra të shkurtër, shkronja dhe simbole brenda vetë njësive bibliografike për të dalluar lloje të ndryshme të informacioneve brenda

Formati MARC

të kuptuarit e njësive bibliografike

Njësia e njëjtë me tage në formatin MARC

"Shenjat orientuese"		Informacioni
100	1#	Sa Arnosky, Jim.
245	10	Sa Raccoons and ripe corn / Sc Jim Arnosky.
250	##	Sa Botimi 1.
260	##	Sa New York : Sb Lothrop, Lee & Shepard Books, Sc c1987.
300	##	Sa 25 p. : Sb me ilustr. me ngjyra ; Sc 26 cm.
520	##	Sa Rakunët e uritur festojnë natën në fushën me misër të pjekur.
650	#1	Sa Rakunët.
900	##	Sa 599.74 ARN
901	##	Sa 8009
903	##	Sa \$15.00

asaj njësie. Formatu fillestar MARC i Bibliotekës së Kongresit u zhvillua në formatin MARC 21, i cili është bërë standardi më i përdorur nga shumica e programeve kompjuterike të bibliotekave. Formatu MARC 21 për njësitë bibliografike, si dhe të gjitha dokumentacionet zyrtare për formatin MARC 21, mirëmbahet nga Biblioteka e Kongresit. Ajo është botuar si *Formati MARC 21 për njësitë bibliografike* (ang.: MARC 21 Format for Bibliographic Data).

PJESA III

TERMINOLOGJIA E FORMATIT MARC DHE DEFINICIONET E TYRE

Kjo pjesë ka të bëjë me atë se si t'i lexojmë, kuptojmë dhe t'i përdorim njësitë në formatin MARC. Ka të bëjë me atë se çfarë shohin bibliotekarët në ekranin e kompjuterit të tyre gjatë përdorimit të një sistemi të automatizuar me rastin e krijimit, redaktimit apo kontrollimit të njësive bibliografike. Një theks i veçantë do t'u kushtohet atyre fushave të cilat përdoren më së shpeshti për të kataloguar materiale për bibliotekat e vogla shkollore dhe ato publike, d.m.th., të materialeve libra dhe audio-vizuele. Megjithatë, ajo që shtjellohet në këtë pjesë, zbatohet në tërësi për të gjitha formatet e materialeve, duke përfshirë incizimet zanore, programet kompjuterike, hartat, dhe njësitë e tjera jo-libër.

Ndryshimet e miratuara së voni, disa prej të cilave tashmë janë vënë në jetë, në formatin MARC për njësitë bibliografike, përfshin edhe konceptin "integrim formatesh". Me termin "integrim formatesh" nënkuptohet përdorimi i njësuar i "shenjave orientuese" për t'i shënuar të dhënat në njësi bibliografike për të gjitha llojet e materialeve se sa të përdoren grupe të

———— Formati MARC ———— të kuptuarit e njësive bibliografike

ndryshme “të shenjave orientuese” për secilin grup të llojeve të materialeve.

Në shembullin e dhënë në numrin e kaluar të revistës në faqe 10, është paraqitur një njësi në formatin MARC e etiketuar me “shenjat orientuese”. Emri i duhur i këtyre “shenjave orientuese” do të ishte: *fusha, tagu, treguesi, nënfusha, kodet e nënfushave, dhe treguesit e përmbajtjes*. Kjo terminologji e formatit MARC 21 është shtjelluar në këtë pjesë.

1. Fushat janë të shënuara me tage.

Fusha: Secila njësi bibliografike është e ndarë në mënyrë logjike nëpër fusha. Ekziston një fushë e veçantë për autorin, një fushë për informacionin e titullit e kështu më radhë. Këto fusha janë të ndara në një apo më shumë “nënfusha”.

Siç e kemi përmendur edhe më herët, emrat e fushave në formë tekstuale janë shumë të gjata për t’u riprodhuar në secilën prej fushave të njësive në formatin MARC. Kështu që ato zëvendësohen me një tag tre-shifrorë. (Edhe pse katalogët në Internet mund t’i shfaqin edhe emrat e fushave në formë tekstuale, ato mundësohen nga softueri e jo nga njësitë në formatin MARC).

Tagu: Secila fushë shoqërohet me një numër tre-shifrorë të quajtur “tag”. Tagu e identifikon fushën – llojin e informacionit – që pason. Tagu paraqitet gjithmonë me tre numrat e

parë, edhe pse kompjuterët mund t’i shfaqin ata së bashku me treguesit (që mund të duket se kemi të bëjnë me një numër 4 ose 5 shifrorë).

Taget e përdorura më së shpeshti janë:

- Tagu 010** - numri i kontrollit të Bibliotekës së Kongresit
- Tagu 020** - numri standard ndërkombëtar i librit
- Tagu 100** - përcaktuese kryesore e emrit (autorit)
- Tagu 245** - informacioni i titullit (i cili përfshin titullin, informacionet shtesë të titullit, si dhe personat përgjegjës të veprës)
- Tagu 250** - ribotimi
- Tagu 260** - informacionet e botimit
- Tagu 300** - përshkrimi fizik
- Tagu 440** - informacioni i serisë apo koleksionit përcaktuese shtesë
- Tagu 520** - vërejtja anotuese apo përmbledhëse
- Tagu 650** - përcaktuese lëndore tematike
- Tagu 700** - përcaktuese shtesë të emrit personal (bashkautor, redaktor, apo ilustrues)

Këtu po japim një shembull të një fushe. Numri 100 është një tag, i cili e përcakton këtë fushë si përcaktuesen kryesore të emrit personal.

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

Shërbimi i shpërndarjes së njësive kataloguese (në ang.: Cataloging Distribution Service, CDS) të

100 1# Sa Pirsig, Robert M.

Bibliotekës së Kongresit e mirëmban dhe e shpërndan listën e hollësishme të të gjitha tageve, si në dokumentin e plotë "Formati MARC 21 për njësitë bibliografike" (në original: MARC 21 Format for Bibliographic Data), si dhe në versionin e përmbledhur me titull "Formatet MARC 21" (në ang.: MARC 21 Concise Formats). Gjatë punës me formatin MARC, ju këshillojmë që t'i përdorni këto dy dokumente. Ato janë dokumente të hollësishme, të cilat përmbajnë shembuj të shumtë. (Shih bibliografinë në fund për referenca më të plota)

Në njësitë në formatin MARC, 10% e tageve përdoren në mënyrë të pandërprerë, ndërsa pjesa tjetër prej 90% përdoret herë pas herë për të mos thënë fare rrallë. Madje pas një periudhe të shkurtër të përdorimit të formatit MARC, nuk është e pazakontë t'i dëgjojmë bibliotekarët duke folur me gjuhën e formatit MARC. Bibliotekarët që punojnë me njësitë në formatin MARC i mësojnë përmendësh numrat e fushave, të cilat janë të zakonshme për materialet të cilat i katalogojnë.

Një përshkrim i atyre 10% të tageve, të cilat përdoren më së shpeshti, janë përfshirë në pjesën e VII të kësaj broshure. Ndërsa, një listë e shkurtër e

disa prej tageve të tjera është përfshirë në pjesën e VIII.

2. Disa prej fushave identifikohen më tej prej treguesve.

Treguesi: Dy pozita të rezervuara vijnë menjëherë pas secilit tag (me përjashtim të fushave 001 deri 009). Një ose të dy nga këto pozita mund të përdoren për t'i vendosur "treguesit." Në disa prej fushave përdoret vetëm treguesi i parë ose i dytë; në disa të tjera përdoren ty dy treguesit; e në disa fusha, si fusha 020 dhe 300, nuk përdoret asnjë prej treguesve. Në ato raste kur nuk përdoren treguesit në asnjërën prej pozitave, ai tregues do të thotë se është "i papërcaktuar" dhe pozita lihet e zbrazët. Në këtë dokument do të përdorim shenjën "#" për të paraqitur një pozitë të zbrazët apo tregues të papërcaktuar.

Vlera e secilit tregues është një numër prej 0 deri 9. (Edhe pse rregullat shkruajnë se treguesi mund të jetë edhe shkronjë, ato zakonisht nuk përdoren. Edhe pse treguesit mund të duken se janë një numër i përbashkët 2 shifrorë, ata në të vërtetë janë dy numra të ndryshëm me vlera të pavarura nga njëri-tjetri. Vlerat e treguesve dhe kuptimi i tyre është shpjeguar në dokumentacionin e formatit MARC 21. Në shembullin pasues, 3 shifrat e para paraqesin tagun (numri 245 e definojnë këtë si fusha e titullit) dhe dy shifrat pasuese (numri 1 dhe 4) janë vlerat e treguesve. Numri 1 është

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

treguesi i parë; 4 - është treguesi i dytë. Vlera e treguesit të parë "1" në fushën e titullit tregon se ekziston një përcaktuese e veçantë e titullit në

245 14 \$a The emperor's new clothes /
\$c adapted from Hans Christian
Andersen and illustrated by Janet Stevens.

katalog. Po të kishim të bënim me skeda në letër, kjo do të thoshte se do të duhej të shtypej një skedë për këtë njësi dhe një përcaktuese për "Titullin" që do t'i shtohet indeksit për kërkim. Treguesi i parë me vlerë "0" në fushën e titullit do të nënkuptonte se titulli paraqet përcaktuesen kryesore; skeda do të shtypej në formën e saj të rregullt tradicionale, pa përcaktuese të veçantë për titullin (pasi ajo është vetë përcaktuese kryesore në këtë rast).

Karakteret, të cilat nuk numërohen: Njëri prej treguesve më karakteristik është treguesi i dytë në fushën e titullit. Ai paraqet numrin e karaktereve në fillim të një fushe (përfshirë edhe hapësirat), të cilat nuk do të numërohen nga kompjuteri në rast të procesit të shfletimit apo dhe renditjes së përcaktueseve në sistem. Për titullin e mësipërm "The emperor's new clothes", vërejmë se treguesi i dytë është "4", kështu që katër karakteret në fillim (shkronjat "t", "h", "e", si dhe hapësira që pason) nuk do të numërohen nga kompjuteri dhe se titulli do të radhitet në sistem nën fjalën e parë "emperor's".

3. Nënfishat identifikohen me kode të nënfushave dhe dilimetër

Nënfisha: Shumica e fushave përmbajnë pjesë të ndryshme të informacionit të lidhura me njëra-tjetrën. Secili lloj i informacionit brenda një fushe quhet nënfushë, dhe secilës nënfushë i paraprinë kodi i nënfushës. Fushat prej 001 deri 009 nuk kanë nënfusha.

Për shembull, fusha e përshkrimit fizik të një materiali libër (e përcaktuar me tagun 300) përfshinë nënfushën për numrin e faqeve, një nënfushë tjetër për hollësira të tjera fizike (ilustrimet), si dhe një nënfushë për dimensionet (centimetrat):

300 ## \$a 675 f. : \$b me ilustr. ; \$c 24 cm.

Kodi i nënfushës: Kodet e nënfushave shprehen me shkronja të vogla (e nganjëherë edhe me një numër) të paraprirë prej një dilimetri. Dilimetri është një shenjë që shërben për t'i ndarë nënfushat nga njëra-tjetra. Secili kod i nënfushës tregon se çfarë lloj informacion ka aty. (Dokumentacioni i formatit MARC 21 paraqet në formë listash dhe i përshkruan të gjitha kodet e nënfushave për secilën fushë në formatin bibliografik).

Dilimetri: Programet e ndryshme kompjuterike përdorin shenja të ndryshme për të shfaqur dilimetrin në ekran të kompjuterit apo për të shtypur informacionin. Për shembull, përdoren shenjat (‡), (@), (\$), (_), apo edhe ndonjë shenjë tjetër. Në këtë dokument ne do të përdorim shenjën

———— Formati MARC ———— të kuptuarit e njësive bibliografike

e dollarit (\$) si dilimetër që paraqet një pjesë të kodit të nënfushës.

Në shembullin e mësipërm, kodet e nënfushave janë \$a - për faqet, \$b - për hollësitë e tjera fizike, dhe \$c - për dimensionet.

4. Treguesit e përmbajtjes – është një term i gjerë që u referohet tageve, tregueseve, dhe kodeve të nënfushave

Të tri llojet e treguesit të përmbajtjes – taget, treguesit, dhe kodet e nënfushave – janë shenjat kryesore në sistemin e shënjimit të formatit MARC 21. Në librin e tij, *Formati MARC për përdorim në biblioteka* (botimi i dytë (Boston: G.K. Hall & Co., 1989) f. 5) (në origjinal: MARC for Library Use), Walt Crawford e quan sistemin e formatit MARC një sistem i cili përdor “shenja-simbole”. Të tri llojet e treguesve të përmbajtjes janë shenja-simbole të shkurtra, të cilat i emërtojnë dhe i shpjegojnë njësitë bibliografike.

5. Disa rregulla të përgjithshme

Ekzistojnë disa rregulla të përgjithshme të cilat ndihmojnë në kuptimin e të gjithë atyre numrave të përdorur si tage të fushave. Ju lutem vëreni që në diskutimet për taget në formatin MARC 21, shenjat XX do të përdoren për të shprehur një grup të përafërt tagesh. Për shembull, 1XX paraqet të gjitha taget me 100, si: 100, 110, 130, e kështu më radhë.

A. Taget e ndarë me qindëshe. Ndarja themelore e njësive bibliografike në formatin MARC 21 është:

0XX Informacioni kontrollues,
numra, kode

1XX Përcaktueset kryesore

2XX Titujt, ribotimi, botimi (në përgjithësi, titulli, informacioni për personat përgjegjës, ribotimi, dhe informacionet e botimit)

3XX Përshkrimi fizik, etj.

4XX Informacionet për serinë apo koleksioni (siç paraqitet në libër)

5XX Vërejtjet

6XX Përcaktueset shtesë lëndore

7XX Përcaktueset shtesë, përveç atyre lëndore apo të serive

8XX Përcaktueset shtesë të serive (forma të tjera të autorizuara)

Fushat 9XX janë të papërcaktuara dhe ato mund të definohen për përdorim brenda një hapësire të caktuar sipas nevojave të një biblioteke. Biblioteka të caktuara, shtëpi botuese apo shitës, mund t'i përcaktojnë ato fusha për të shënuar informacione shtesë një njësie bibliografike. (Fushat X9X në secilin prej këtyre grupeve – 09X, 59X, etj. – janë po ashtu të rezervuara për përdorim të brendshëm, përveç fushës 490).

Lista e tageve më të përdorura tregon se si përshtaten secila prej tyre në këto ndarje: fusha 100 është përcaktuese kryesore për autorin; fusha 520 - është për vërejtjet e përmbledhjes, e kështu më radhë.

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

B. Pikat e qasjes. Pikat e qasjes (përcaktuesja kryesore, përcaktueset shtesë lëndore, dhe përcaktueset e tjera shtesë) janë pjesë të rëndësishme të njësive bibliografike. Këto janë përcaktuese për të cilat krijoheshin skeda të veçanta në katalogët tradicionalë prej letre, dhe se tani përdoruesi apo bibliotekari mund të kërkojë me ndihmën e tyre në katalogun në Internet. Pjesa më e madhe e pikave të qasjes janë në:

- Fushat 1XX (përcaktueset kryesore)
- Fushat 4XX (Informacionet për serinë apo koleksionin)
- Fushat 6XX (Përcaktueset lëndore)
- Fushat 7XX (Përcaktueset shtesë, përveç atyre lëndore dhe serive)
- Fushat 8XX (Përcaktueset shtesë të serive)

Këto fusha janë të kontrolluara me anë të njësive të autorizuara.

“**Kontrolli i autorizuar**” nënkupton respektimi i një forme të njohur apo të themeluar. Zakonisht, një katalogues e zgjedh një përcaktuese lëndore apo të emrit nga një listë e miratuar e përcaktueseve. Për shembull, gjatë një bisede, nëse ju flisni për një vizitë në “Getty Museum” dhe “J. Paul Getty Museum” në Kaliforni, ai që ju dëgjon do të kuptojë se ju flisni për gjënë e njëjtë. Mirëpo nëse një katalogues njëherë përdor “Getty Museum” dhe herën tjetër “J. Paul Getty Museum”, si përcaktuese në katalog, atëherë përdorue-

si i bibliotekës do ta ketë të vështirë t’i gjejë të gjitha librat në atë lëmi. Nëse kataloguesi e respekton listën e Bibliotekës së Kongresit për formën e autorizuar të emrave, ai apo ajo do ta përdorë përcaktuesen “J. Paul Getty Museum.” Nëse e respekton gjithnjë këtë rregull, atëherë të gjitha librat për atë muze do të gjenden në një vend në katalog.

Lista më e mirë për emra është Lista e emrave të autorizuar të Bibliotekës së Kongresit. Kjo listë ekziston në format të kuptueshëm për kompjuterin të vënë në dispozicion nga Shërbimi për shpërndarjen e njësive kataloguese të bibliotekës së Kongresit apo në Internet në: <http://authorities.loc.gov>. Forma e autorizuar e emrave në përdorim (emra personal, emra të korporatave, emra të konferencave apo takimeve, tituj të serive, dhe tituj uniform) mund të krahasohet me këtë listë të autorizuar.

Ndërsa për emrat lëndorë apo gjeografikë, listat më të zakonshme të autorizuara janë *Lista e përcaktueseve lëndore të Bibliotekës së Kongresit* dhe *Lista e përcaktueseve lëndore Sears*. Forma e një përcaktuese lëndore duhet të jetë në përputhje me njëren prej këtyre listave ose të respektohen rregullat për krijimin e një përcaktuese të re.

Në një kompjuter personal është e vështirë që të ruhen të gjitha listat e autorizuara të Bibliotekës së Kongresit. Kështu që, pesë vëllime të mëdha e

————— Formati MARC ————— të kuptuarit e njësive bibliografike

përfshijnë *Listën e përcaktueseve lëndore të Bibliotekës së Kongresit*. Shkollat dhe bibliotekat speciale zakonisht përdorin vetëm një pjesë të tyre.

Ajo që është me rëndësi ka të bëjë me “kontrollin e brendshëm të autorizuar” të bibliotekave me katalog të kompjuterizuar. Ky lloj kontrolli u ndihmon bibliotekarëve të kërkojnë listën e përcaktueseve lëndore ose të emrave të autorizuar në sistem dhe të përdorin atë i cili gjendet aty. Në këtë mënyrë, të gjitha përcaktueset për emrin e njëjtë të një personi apo lënde do të përdoren në mënyrë krejtësisht të njëjtë – që është edhe krejt rëndësia e njësive të autorizuar. Emrat të cilët i gjejmë në Katalogimin në botim (CIP), në libra po ashtu, bazohen në njësitë e autorizuar të Bibliotekës së Kongresit në kohën kur ato botohen. Po ashtu, edhe format e shfaqura për materialet e botuara në katalogët në Internet, pas konvertimit retrospektiv, duhet të jenë të sakta pasi gati të gjitha bazat e të dhënave të shitësve të ndryshëm bazohen në listat e formatit MARC të Bibliotekës së Kongresit.

Shprehja “konvertim retrospektiv” paraqet projektin për konvertimin e njësive bibliografike nga forma e tyre fillestare – si e skedave apo e njësive të krijuara shkurt në qarkullim – në njësi të plotë bibliografike të kuptueshme nga kompjuteri. Shprehja retrospektiv përdoret për arsye se projekti bëhet për koleksionet ekzistuese të një biblioteke – të gjitha materialet që gjenden në bibliotekë deri në kohën kur fillon konvertimi. Konvertimi retrospektiv

zakonisht bëhet duke i krahasuar njësitë e vjetra bibliografike të bibliotekës (pa marrë parasysh a janë në skeda letre apo ndonjë format që nuk bazohet në formatin MARC) me një bazë të dhënash me njësi të plota bibliografike. Bibliotekari mund të blejë njësi ekuivalente në formatin MARC se sa të futë në kompjuter në mënyrë mekanike të gjitha informacionet për të krijuar një njësi të re bibliografike.

Përmbajtja paralele. Fushat të cilat kërkojnë kontrollin e autorizuar janë fusha që po ashtu përdorin një ndërtim paralel të tageve. Në përgjithësi, në fushat 1XX, 4XX, 6XX, 7XX dhe 8XX, një emër personal do të ketë dy shifrat e fundit 00. Prandaj, për një përcaktuese kryesore (1XX) që është emër personal (X00) tagu i saktë do të jetë 100. Për një përcaktuese lëndore (6XX) që është emër personal, tagu i saktë është 600, e kështu më radhë. Kjo përmbajtje paralele mund të përmbledhet si vijon:

- X00 Emrat personal
- X10 Emrat e korporatave
- X11 Emrat e takimeve
- X30 Titujt uniform
- X40 Titujt bibliografikë
- X50 Terma (përcaktuese) lëndore
- X51 Emra gjeografikë

Nëse e kombinojmë këtë paraqitje të fushave me fushat më lartë të ndara në qindëshe, bëhet e qartë se, nëse një libër ka për tematikë lëndore (6XX) një person (Lincoln, Abraham), tagu

———— Formati MARC ———— të kuptuarit e njësive bibliografike

do të jetë 600; nëse tematika lëndore e një libri është korporat (Apple Computer, Inc.), tagu do të jetë 610; nëse tematika lëndore e një libri është (hekurudhat), atëherë tagu do të jetë 650; nëse tematika lëndore e një libri është një vend (Shtetet e Bashkuara), tagu është 651. Një përcaktuese shtesë (7XX) për bashkautor (emër personal) do të marrë tagun 700.

Sistemi i klasifikimit sipas Dewey-it përdor një ndërtim të ngjashëm të tabelave për vendet gjeografike dhe për nënndarjet standarde të këtij sistemi.

6. Informacionet unike paraqiten në fillim të njësive të formatit MARC

Njësia në formatin MARC në pjesën që i paraprin përmbajtjes kryesore të njësive bibliografike – e cila është e njohur për bibliotekarët për shkak të pranisë së tyre në katalogët prej skedave në letër – përmban informacione më pak të njohura. Katalogët e automatizuar zakonisht i krijojnë në mënyrë automatike të dhëna në mënyrë që bibliotekari të mund t'i fusë informacionet e duhura.

Numri udhëheqës. Numri udhëheqës paraqet 24 karakteret e para që shfaqen në një njësi. Secila pozitë e ka kuptimin e vet të caktuar, mirëpo pjesa më e madhe e informacionit i hyn në punë kompjuterit. Programet për krijimin edhe redaktimin e njësive në formatin MARC i japin bib-

liotekarit zakonisht mundësi të ndryshme për t'ia lehtësuar punën, nëse nevojitet që ai të plotësojë ndonjë prej elementeve në numrin udhëheqës. Hollësirave për ta plotësuar dhe interpretuar numrin udhëheqës, do t'i japim në një botim të plotë.

Numri orientues. Njësitë në formatin MARC quhen njësi të etiketuara me tage. Para se të etiketohet, njësia në formatin MARC (në formatin komunikues MARC) duket krejtësisht ndryshe – ashtu si një fjali e gjatë. Në formatin komunikues, fushat nuk paraprihen me tage. Megjithatë, menjëherë pas numrit udhëheqës, radhitet një grup i të dhënave që quhet numër orientues. Ky numër orientues tregon se çfarë tage gjenden në atë njësi dhe se në cilën pozitë gjenden (duke i llogaritur karakteret deri te secila pozitë ku fillon secila fushë). Numri orientues krijohet nga kompjuteri, duke u bazuar në njësinë bibliografike, duke u bazuar në informacionet e kataloguara, dhe, nëse informacionet në nënjësinë bibliografike ndryshojnë, ai mund të ndryshojë po ashtu. Në një botim të plotë të kësaj broshure, do të japim hollësitrat se si funksionon ky numër.

Fusha 008. Fushës 008 i referohemi si fusha me gjatësi fikse të elementeve të të dhënave, apo fusha me kode fikse. Të 40-të karakteret e kësaj fushe përmbajnë informacione të rëndësishme, mirëpo në një formë të shkurtër. Edhe pse nuk përdoret ende

———— Formati MARC ————
të kuptuarit e njësive bibliografike

në tërësi në katalogët në Internet, kjo fushë mund të përdoret për të identifikuar dhe nxjerrë njësi të cilat përputhen me kriteret të caktuara.

Për shembull, ekziston një kod në këtë fushë që tregon se një libër është i shtypur në shkronja të mëdha, një kod tjetër që identifikon vendin e botimit, një tjetër që identifikon materiale për të rinj, një kod që tregon gjuhën e tekstit, e kështu më radhë. Hollësitë e mëtejme për interpretimin e fushës 008 për katalogimin e një libri janë dhënë në pjesën X.

=====

PJESA IV

**Ku e kanë zanafilin
njësitë në formatin
MARC?**

Shkëmbimi i informacionit katalogues – shkëmbimi i njësive bibliografike – është një realitet për shumë vite. Shumë bibliotekarë kanë zgjedhur që t'i shfrytëzojnë në maksimum burimet e kufizuara, duke e shkëmbyer informacionin e kataloguar se sa ta krijojnë një njësi bibliografike nga a para. Tani për gati një shekull ata kanë mundur të porosisin skeda letre për librat e tyre të rinj nga Biblioteka e Kongresit, apo nga tregtarë me shumicë të librave.

Të tjerët i shtypnin skedat e tyre, duke e shfrytëzuar informacionin e Katalogimit në botim (CIP) në shumicën e librave. Bibliotekarët i kanë përshtatur në mënyrë të plotë apo pjesërisht njësitë kataloguese të shtypura në revista të bibliotekave apo në bibliografi të ndryshme.

Me daljen e kompjuterit në skenë, bibliotekarët nuk kishin më nevojë të shpiknin gjënë e njëjtë për herë të dytë. Pse duhej që qindra katalogues ta shfrytëzojnë kohën e tyre të vlefshme për të krijuar një njësi bibliografike po thuaj identike për një titull të njëjtë, kur vetëm një katalogues mund ta kryejë atë dhe pastaj ta shkëmbejë me të tjerët? Pse duhej që qindra daktilografë të shtypin e rishtypin njësinë e njëjtë bibliografike në skeda prej letre, kur kom-

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

pjuteri mund të programohet që t'i shtyp ato?

Pasi që u krijua formati MARC, bibliotekat përfitonin nga shkëmbimi i njësive të kataloguara bibliografike, pa marrë parasysh se a kishin katalog elektronik apo jo. Skedat që bliheshin nga Biblioteka e Kongresit apo nga tregtarë me shumicë të librave, shtypeshin me anë të kompjuterit nga baza e njësive bibliografike në formatin MARC të Bibliotekës së Kongresit .

Kolegjet dhe universitetet me buxhete të mëdha për bibliotekat e tyre iu bashkuan programeve të ndryshme të bashkëpunimit, si: OCLC, WLN, RLIN dhe A-G Kanada. Për një çmim anëtarësie, si dhe pagesa shtesë për mbajtje të komunikimit, departamentet e tyre të përpunimit të materialit bibliotekar u automatizuan, duke i shfrytëzuar kompjuterët e fuqishëm të këtyre kompanive. Këto përpjekje u mundësuan atyre bibliotekave për t'i shfrytëzuar dhe për të kontribuar njësitë e krijuara në formatin MARC. Skedat prej letre mund të porositeshin, dhe një printer mund të lidhej në sistem për t'i pranuar të dhënat përmes linjës telefonike në mënyrë që të shtypte etiketat e librave.

Tani jemi në një epokë ku ekzistojnë kompjuterë të fuqishëm dhe jo të shtrenjtë për menaxhimin e veprimtarisë së një biblioteke të çfarëdolloj dhe madhësie. Softuerët kompjuterikë i mundësojnë një biblioteke të ketë sistemin e saj të pavarur të qarkullimit apo edhe katalogun elektronik në internet. Këto programe shpesh mund të lexojnë, ruajnë, dhe shtypin njësi të

krijuara në formatin MARC. Kompjuterët e sotëm përdorin disqe të ndryshme për të ruajtur informacionet për ndryshim të kompjuterëve të mëhershëm, të cilët i ruanin informacionet në shirita magnetik. Sa u përket kompjuterëve, informacionet dërgohen dhe pranohen përmes përdorimit të disqeve në floppy. Prej këtyre disqeve, njësitë bibliografike futeshin në diskun kryesor të kompjuterit.

Me ndryshimin e teknologjisë së automatizimit si dhe të nevojave të katalogimit, po ndryshon edhe dokumentacioni i formatit MARC 21 dhe i dokumentacioneve të tjera lidhur me këtë format. Edhe pse formati fillestar MARC 21 ishte përpiluar nga Biblioteka e Kongresit dhe se dokumentacioni i këtij formati mirëmbahet dhe botohet në atë bibliotekë, Biblioteka e Kongresit nuk i bën ndryshimet dhe korrigjimet e këtij formati në mënyrë të njëanshme.

Ekzistojnë dy grupe, MARBI dhe Komiteti këshillues për formatin MARC, të cilat janë përgjegjëse për rishikimin dhe bërjen e ndryshimeve në dokumentacionin e formatit MARC 21. Komiteti i MARBI-it (Machine-Readable Bibliographic Information) është një komitet i deleguar i Shoqatës së bibliotekave amerikane (ALA) dhe përbëhet prej tre përfaqësuesve për secilin prej tri funksioneve të divizioneve të ALA-sL: ALCTS (funksionit të shërbimeve të përpunimit); LITA (automatizim); dhe RUSA (referencë). ALA përpiket të sigurojë që të tri llojet e ekspertizës

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

të përfaqësohen në komitetin e MARBI-it. Komisioni këshillues i formatit MARC përbëhet prej përfaqësuesve të bibliotekave kombëtare, shërbimeve bibliografike, grupeve të shitësve me shumicë të materialeve bibliotekare, si dhe të shoqatave të tjera bibliotekare e hulumtuese. Komiteti i MARBI-it takohet së bashku me Komitetin këshillues të formatit MARC në secilën prej konferencës së ALA-s (vjetore dhe mes sezonit të dimrit). Aktiviteti kryesor i Komitetit është të rishqyrtojë diskutimet dhe propozimet e dorëzuara nga ose përmes Bibliotekës së Kongresit për ndryshimet dhe për shtesat që duhet bërë në formatet ekzistues MARC, apo për zhvillimet e reja në formatin MARC në mbështetje të fushave të reja në zhvillim.

Në vitin 1987 Biblioteka e Kongresit e nxori nga shtypi botimin e parë të dokumentit "Specifikacionet e formatit MARC 21 për strukturën, kodet, dhe mjetet e shkëmbimit" për t'iu ndihmuar bibliotekave dhe organizatave të tjera, të cilat krijojnë apo marrin njësi në formatin MARC 21. Edhe botime të tjera pasuese të këtij dokumenti u ribotuan më 1990, 1994 dhe 2000. Ky dokument ofron informacione teknike sa i përket strukturës së njësive në formatin MARC, kodeve të përdorura dhe formatin në të cilën mund të shpërndareshin njësitë e krijuara në formatin MARC 21. Ka për qëllim personelin e përfshirë në dizajnimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve për shkëmbim dhe përpunim të një-

sive në formatin MARC.

Me përhapjen e sistemeve kompjuterike në biblioteka u bë e qartë se nevojitej po ashtu edhe një standard që do të bënte të mundur shkëmbimin e njësive në formatin MARC përmes disketave. Bashkëpunimi i ngushtë me tregtarët e mëdhenj të librave dhe të shkëmbimit të informacioneve si dhe kompanive komerciale të sistemeve të automatizuara bibliotekare, MARBI dhe Komiteti këshillues i formatit MARC paraqiti disa propozime, të cilat nxorën si rezultat nevojën për ndryshimin dhe shtimin e karakteristikave në formatin MARC 21 për të mundësuar transferimin e saktë dhe të plotë të këtyre të dhënave duke përdorur disketa.

Së voni janë zhvilluar specifika edhe më të përsosura për shpërndarjen e njësive në formatin MARC përmes transferimit të fajllit (FTP). Këto specifika të shpërndarjes së njësive në formatin MARC përmes disketave apo FTP-së dolën së pari në botimin e vitit 1994.

Bibliotekarët, tregtarët me shumicë të librave – e çdo kush tjetër – i cili merrej me shpërndarjen e të dhënave bibliografike kishte mundësi të ofronte njësi të kataloguara në formë standarde të formatit MARC 21. Kompanitë komerciale të zhvillimit të sistemeve të automatizuara bibliotekare kishin mundësi të dizajnonin sistemet e tyre në mënyrë të saktë për t'i pranuar apo përpunuar njësitë standarde të krijuara në formatin MaRC. Bibliotekarët si individë, të cilët i për-

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

dorin kompjuterët për t'i menaxhuar bibliotekat e tyre, janë ata të cilët i gëzojnë benificionet e drejtpërdrejta nga ky standard në formatin MARC 21.

===== PJESA V

«Është lidhur me tî dhînat nî formatin MARC

Meqë teknologjia e kompjuterëve po përparon ditë e më shumë, atëherë shtrohen një numër çështjesh lidhur me cilësinë e të dhënave në bibliotekë dhe sistemet e automatizuara bibliotekare. Pra ju duhet të mbani një sy në këto çështje dhe rëndësinë e tyre për bibliotekën tuaj.

A. Çështje sa u përket të dhënave: Me rastin e vlerësimit të njësive duhet t'i kemi në mendje një numër pyetjesh të rëndësishme: *Ç'cilësi kanë të dhënat apo njësitë në formatin MARC? Cilat fusha të formatit MARC 21 janë të pranishme? A janë të dhënat e krijuara në bazë të formatit MARC të Bibliotekës së Kongresit? Nëse po, a janë vënë informacione të mjaftueshme në atë njësi? A iu ka shtuar ndonjë gjë tjetër njësisë?*

Disa bibliotekarë kërkojnë nga kompanitë komerciale, të cilat merren me biblioteka për shembuj në letër të formatit MARC, që të mund t'i krahasojnë dhe të shohin se a përputhen ato të dhëna me njësitë në formën standarde

të formatit MARC 21.

Është e qartë se përmbajtja e njësive bibliografike do të përcaktojë në shkallë të madhe suksesin e një sistemi të automatizuar bibliotekar si për ju ashtu edhe për përdoruesit e bibliotekës suaj. Pra, është me shumë rëndësi që të merren njësitë me cilësinë më të lartë që të jetë e mundur.

B. Çështje sa i përket programit kompjuterik: Pyetjet me radhë që ka kuptim të kërkojmë përgjigje pas atyre më lartë janë: *A i shfrytëzon në maksimum informacionet në katalog sistemi i automatizuar bibliotekar të cilin e kemi zgjedhur? A ruhen të gjitha informacionet përfshirë edhe treguesit e përmbajtjes në formatin MARC 21?*

A i merr sistemi të gjithë informacionin e një njësie, pa ndonjë kufizim të paarsyeshëm apo fals në gjëra të tilla si numri i përcaktueseve lëndore, të cilët do të futen në indeks apo gjatësia e fushave të vërejtjeve? Edhe pse disku ka përmbajtje të shkëlqyeshme, njësi të plota, secili sistem i automatizuar bibliotekar do të mund të përdorë vetëm ato informacione të cilat janë transferuar në diskun e kompjuterit. (Nëse një sistem i qarkullimit i merr vetëm informacionet e qarkullimit, është me rëndësi që disqet me të dhëna në formatin MARC 21 t'i mirëmbajmë dhe t'i plotësojmë më vonë, duke i kthyer në njësi të plota bibliografike me qëllim që ato të mund të krijojnë katalogun elektronik në internet.

A janë shfaqur në ekranin e kompjuterit të bibliotekarit taget e formatit

Formati MARC të kuptuarit e njësive bibliografike

MARC, pastaj treguesit, kodet e nënfushave? A janë përdorur me saktësi treguesit? A janë përdorur me saktësi kodet e nënfushave? (Informacionet në pjesën VII do t'ju ndihmojnë për të vlerësuar me saktësi përdorimin e treguesve të përmbajtjes, si taget, treguesit dhe kodet e nënfushave).

Pasi që njësitë të futen në një bazë të dhënash, është me rëndësi që ato të ruhen në formatin MARC 21 të njësive bibliografike. Projektet e ardhshme mund të paraqesin nevojën e përdorimit të tyre. Formatin MARC 21 është një standard i përdorur gjerësisht. Me daljen e programeve të reja, pjesëmarrja e një biblioteke në to varet nga cilësia e njësive bibliografike të cilat i posedon. Kjo na sjell në një pikë tjetër. A lejon sistemi që njësitë të nxirren, apo të incizohen në një disk tjetër, që ato të përdoren në ndonjë projekt tjetër, si p.sh. në një projekt të një katalogu përmbledhës?

A do të ketë një program, i cili do të mund t'i incizojë ato në atë mënyrë që të komunikojnë sërish në formatin MARC? (Shih pjesën XI për një diskutim të formateve të ndryshme komunikuese.)

PJESA VI

PËr fundim

Gjatë këtyre faqeve ju keni mësuar se çfarë do të thotë akronimi MARC. Keni kuptuar po ashtu rëndësinë e një formati standard për identifikimin e elementeve të informacionit të njësive bibliografike si dhe rëndësinë e tyre më tej. Po ashtu, keni mësuar të përcaktoni dhe identifikoni tri llojet e treguesve të përmbajtjes në formatin MARC: taget, kodet e nënfushave, dhe treguesit. Më e rëndësishmja, me këtë njohuri ju mund të kuptoni çështjet të cilat ju brengosin kur të keni ndërmend të blini njësi bibliografike apo një sistem të automatizuar bibliotekar.

Për të ndërtuar edhe më tej këto njohuri themelore, ju sugjerojmë të lexoni edhe materiale të tjera të kësaj fushe apo të kryeni ndonjë kurs në katalogët elektronik. Kemi sugjeruar një varg titujsh për lexim në pjesën e bibliografisë në fund të kësaj broshure. Formatin MARC mund të duket i vështirë në fillim, por me shtimin e njohurive dhe përdorimin e tij, do të fillojë të qartësohet dhe të kuptohet shumë lehtë. Sa më shumë që të mësoni të punoni me këtë format, aq më i thjeshtë do t'ju duket.

MATERIALE SHITESÀ PËR FORMATIN MARC 21

PJESA VII

PËRMBLEDHJE E FUSHAVE QË PËRDOREN MË SË SHPESHTI NË FORMATIN MARC 21

Kjo është një përmbledhje e tageve në formatin MARC 21, të cilët përdoren më së shpeshti nëpër biblioteka gjatë krijimit të njësive bibliografike. Listën e plotë të fushave të formatit MARC 21, të treguesve dhe kodeve të nënfushave mund ta gjeni në *Formatin MARC për njësitë bibliografike*. Shpjegime të mëtutjeshme:

Taget – Taget (numër 3-shifror) janë të shoqëruara me emrat e fushave, të cilat i përfaqësojnë. Në këtë përmbledhje, si dhe në *Formatin MARC21 për njësitë bibliografike*, nëse një tag (fushë) mund të përsëritet me shumë se një herë brenda një njësie bibliografike, atëherë ai është i përsëritshëm dhe shoqërohet me shkronjën (R, në anglisht – R – Repeatable, që do të thotë e përsëritshme). Nëse mund të përdoret vetëm njëherë brenda një njësie bibliografike, atëherë ajo është e papërsëritshme dhe shoqërohet me shkronjat (NR, në anglisht Non-Repeatable që do të thotë e papërsëritshme). Për shembull, një njësi bibliografike mund të ketë disa përcaktuese

lëndore, kështu që taget për përcaktueset shtesë lëndore (6XX) shënjohen me shkronjën (R), pra të përsëritshme.

Treguesit – Përdorimi i treguesve është shpjeguar në fushat përkatëse, në të cilat përdoren. Treguesit janë numra njëshifror. Duke filluar me fushën 010 (Numri kontrollues i Bibliotekës së Kongresit), menjëherë pas tagut të secilës fushë i gjejmë dy pozita të rezervuara për treguesit – njëri për treguesin e parë (1), dhe tjetri për treguesin e dytë (2). Treguesit nuk janë të përcaktuar për secilën fushë. Dhe, është e mundur që, p.sh., të përdoret vetëm treguesi i dytë, ndërsa i pari jo – për shkak se është i papërcaktuar (dhe anasjelltas). Atëherë kur njëri tregues nuk është i përcaktuar, atëherë pozita e atij treguesi do të shënohet me shenjën “#” (për të paraqitur hapësirë të zbrazët, apo të papërcaktuar).

Kodet e nënfushave – Të gjitha informacionet në secilën fushë (duke filluar me fushën 010) ndahen në nënfusha, ku secila prej tyre paraprihet me një kod të nënfushës të shoqëruar me një delimetër. Këtu i kemi paraqitur kodet më të përdorura të nënfushave brenda secilit tag. Secili kod i nënfushave është shënuar me shenjën “\$”, i cili paraqet decimetrin. Emri i secilës nën-

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

fushë pason menjëherë pas kodit. Në përgjithësi, secila fushë duhet të ketë një nënfushë "a" (\$a). Një përjashtim mund të shfaqet mjaft shpesh në fushën 020 (ISBN), kur mungon informacioni i ISBN-së (nënfusha \$a), mirëpo dihet çmimi (nënfusha \$c). Disa prej nënfushave janë të përsëritshme. Në këtë përmbledhje i kemi paraqitur vetëm ato nënfusha, të cilat përsëriten më së shpeshti.

Shembuj: Pas shpjegimit të secilës fushë do të japim edhe shembuj. Për të pasur një pasqyrë më të qartë, do ta lëmë një hapësirë ndërmjet tagut dhe treguesit të parë, një hapësirë do të lihet po ashtu ndërmjet treguesit të dytë dhe decimetrit të kodit të nënfushës së parë, si dhe një hapësirë do të lihet pas kodit të secilës nënfushë dhe informacionit, të cilin e fusim në secilën prej atyre nënfushave.

010 - Numri i kontrollit i Bibliotekës së Kongresit (NR, ose i papërsëritshëm)

Treguesit e papërcaktuar:

Nënfusha e përdorur më së shpeshti:

\$a – Numri kontrollues i Bibliotekës së Kongresit

Shembull: 010 ## \$a ###86000988#

020 - Numri standard ndërkombëtar i librit (ISBN) (R, ose i përsëritshëm)

Treguesit e papërcaktuar:

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Numri standard ndërkombëtar i librit

\$c – kushtet e shfrytëzimit (shpesh çmimi)

\$z – ISBN e anuluar/invalidë (R)

Shembull: 020 ## \$a 0877547637

040 - Burimi i katalogimit (NR)

Treguesit e papërcaktuar:

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Agjencia e katalogimit original

\$c – Agjencia që e kopjon

\$d – Agjencia që e modifikon (R)

Shembull: 040 ## \$a DLC
\$c DLC
\$d gwhs

100 – Përcaktuese kryesore – emër personal (autori kryesor)

(NR; mund të ekzistojë vetëm një përcaktuese kryesore në një njësi bibliografike)

Treguesi 1: Lloji i elementeve të emrit personal

0 – Emri

1 – Mbiemri (kjo është forma më e zakonshme)

3 – Emër familje

Treguesi 2 i papërcaktuar:

Treguesi 2 doli nga përdorimi në vitin 1990. Njësitë e vjetra mund të shfaqin 0 ose 1

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Emër personal

\$b – Numërimi

\$c – Titujt dhe fjalët e tjera që kanë të bëjnë me atë emër (R)

\$q – Forma më e plotë e emrit

\$d – Data lidhur me emrin (zakonisht viti i lindjes)

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

Shembull: 100 1# Sa Gregory, Ruth W.
Sq (Ruth Wilhelme),
Sd 1910-

130 - Përcaktuese kryesore – titull uniform (NR)

Treguesi 1: Karakteret të cilat nuk indeksohen

0-9 – Numri i karaktereve të pranishme që nuk indeksohen (për nyjet në fillim të fjalës, përfshirë edhe hapësirën ndërmjet elementeve)

Treguesi 2 i papërcaktuar.

Treguesi 2 doli nga përdorimi në vitin 1990. (Shih fushën 100 më lart.)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Titull uniform

Sp – Emri i pjesës/seksionit të një vepre (R)

Sl – Gjuha e veprës

Ss – Versioni

Sf – Data e veprës

Shembull: 130 0# Sa Bible.
Sp O.T.
Sp Psalms.

240 - Titull uniform (NR)

Treguesi 1: Titulli uniform të shtypet ose të shfaqet në ekran

0 – Nuk shtypet e as nuk shfaqet në ekran

1 – Shtypet ose shfaqet në ekran (forma më e zakonshme)

Treguesi 2: karakteret që nuk indeksohen
0-9 – Numri i karaktereve të pranishme që nuk indeksohen (për nyjet në fillim të fjalës përfshirë edhe hapësirën ndërmjet elementeve)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Titull uniform

Sl – Gjuha e veprës

Sf – Data e veprës

Shembull: 240 10 Sa Ile mystérieuse.
Sl English.
Sf 1978

245 – Informacionet për titullin (NR)

Treguesi 1: Përcaktuese shitesë e titullit (A duhet të indeksohet titulli si përcaktuese shitesë?)

0 – Pa përcaktuese shitesë tjetër (tregon se titulli është përcaktuese kryesore; d.m.th., nuk ka autor)

1 – Përcaktuese shitesë e titullit (treguesi i duhur kur kemi një autor në fushën 1XX; forma më e zakonshme)

Treguesi 2: karakteret që nuk indeksohen
0-9 — Numri i karaktereve të pranishme që nuk indeksohen përfshirë edhe hapësirën ndërmjet elementeve; zakonisht është zero, përveç nëse titulli fillon me një nyje; p.sh., për titullin “*The robe*”, treguesi i dytë duhet të jetë 4. Shkronjat “T, h, e,” si dhe hapësira që pason nuk indeksohen kur titujt alfabetizohen në sistem. Njësia do të ruhet në mënyrë automatike nën shkronjën “r” – për titullin “*Robe*”.

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Titulli

Sh – Mediumi (shpesh i përdorur për materialet jo-libra)

Sp – Emri i pjesës/seksionit të veprës (R)

Sb – Nëntitulli, etj.

Sc – Personat përgjegjës të veprës

———— Formati MARC ————
të kuptuarit e njësive bibliografike

Shembull: 245 14 \$a The DNA story :
Sb a documentary history of gene
cloning /
Sc James D. Watson, John
Tooze.

246 Forma të ndryshme të titullit (R)

Treguesi 1: Kontrolluesi i përcaktueses
shtesë/vërejtjes

1 – Vërejtje, përcaktuese shtesë e titullit

3 – Pa vërejtje, përcaktuese shtesë e titullit

Treguesi 2: Lloji i titullit

– Nuk jepet informacion

0 – Pjesë e titullit

1 – Titull paralel

4 – Tutull në kopertinë

8 – Titull i shpinës

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – titulli

Shembull: 246 3# \$a Four corners power review

250 - Ribotimi (NR)

Treguesit e papërcaktuar

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Ribotimi

Shembull: 250 ## \$a Botimi 6.

260 - Botimi, shpërndarja, etj.

(Shtypi) (R)

Treguesi 1: Vijueshmëria e botimit

– Nuk jepen informacione

Treguesi 2: I papërcaktuar

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Vendi i botimit, shpërndarjes, etj. (R)

Sb – Emri i botuesit, shpërndarësit, etj. (R)

Sc – Data e botimit, shpërndarjes, etj. (R)

Shembull: 260 ## \$a New York :
Sb Chelsea House,
Sc 1986.

300 - Përshkrimi fizik (R)

Përcaktuesit e papërcaktuar

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Gjatësia (numri i faqeve) (R)

Sb – Hollësitë e tjera të përshkrimit fizik (zakonisht ilustrimet)

Sc – Dimensionet (cm.) (R)

Se – Materiale shoqëruese (për shembull, “Libri i mësuesit” apo “doracak”)

Shembull: 300 ## \$a 139 f. :
Sb ilustr. ;
Sc 24 cm.

440 - Informacione për serinë (koleksionin)/Përcaktuese shtesë e serisë - Titulli (R)

Treguesi 1 i papërcaktuar

Treguesi 2: Karakteret që nuk indeksohen
0-9 – Numri i karaktereve të pranishme që nuk indeksohen (për nyjet në fillim të fjalës përfshirë edhe hapësirën ndërmjet elementeve)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Titulli

Sv – Numri i vëllimit

Sv 26

Shembull: 440 #0 \$a Modern critical views ;

490 - Informacione për serinë (koleksionin) (Përcaktuesja shtesë nga kjo fushë nuk gjurmohet) (R)

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

Treguesi 1: Përcakton nëse seria gjurmohet (nëse një tag 8XX është i pranishëm, që e paraqet në formë të ndryshme serinë)

0 – Seria nuk gjurmohet

1 – Seria gjurmohet në formë të ndryshme (fusha 8XX është e pranishme në njësi bibliografike)

Treguesi 2 i papërcaktuar:

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa - Series statement (R)

Sv - Volume number (R)

Shembull: 490 1# Sa Colonial American craftsmen

500 - Vërejtjet e përgjithshme (R)

Treguesit e papërcaktuar:

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Vërejtje e përgjithshme (Përdoret ku nuk është krijuar asnjë vërejtje formale në ndonjë fushë tjetër të vërejtjeve, nuk është përcaktuar me normë për informacionin në fjalë. Për shembull: Vërejtjet sa i përket indeksit; burimit të titullit; formave të ndryshme të titullit, përshkrimin e natyrës, formës dhe fushëveprimit të njësisë.)

Shembull: 500 ## Sa Indeksi : f. 230-235.

504 - Vërejtjet bibliografike, etj. (R)

Treguesit e papërcaktuar:

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Vërejtja bibliografike, etj.

Shembull: 504 ## Sa Bibliografia : f. 100.

505 - Vërejtjet e formatizuara për përmbajtjen (R)

Treguesi 1: Lloji i vërejtjes së përmbajtjes

0 – Përmbajtja e plotë

1 – Përmbajtja e paplotë (përdoret me kompletet shumëvëlimeshme, kur disa prej vëlimeve nuk janë botuar ende)

2 – Përmbajtja e pjesërishtme

Treguesi 2: Niveli i përshkrimit të përmbajtjes

– I thjeshtë

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Vërejtja e formatizuar e përmbajtjes

Shembull: 505 0# Sa Pride and prejudice - Emma - Northanger Abbey.

520 - Vërejtjet e përmbledhjes, etj. (R)

Treguesi 1: E kontrollon shfaqjen e fjalëve prijëse

– Përmbledhja

1 – Kritikë

2 – Fushëveprimi dhe përmbajtja

3 – Abstrakt

Treguesi 2 i papërcaktuar

Nënfushat e përdorura më së shpeshti

Sa – Summary, abstract, or annotation

Sb – Zgjerim i vërejtjes së përmbledhjes

Shembull: 520 ## Sa Ky udhëzues për procedurat-parlamentare tregon se si duhet të sillemi dhe të marrim pjesë në një takim.

600 - Përcaktuese shtesë lëndore – Emër personal (R)

Treguesi 1: Lloji i elementeve të emrit personal

———— Formati MARC ————
të kuptuarit e njësive bibliografike

- 0 – Emri
- 1 – Mbiemri (Kjo formë përdoret më së shpeshti)
- 3 – Emër familje

Treguesi 2: Sistemi/tezauri i përcaktueses lëndore (identifikon se prej cilës listë është marrë përcaktuesja)

0 – Përcaktuese lëndore e Bibliotekës së Kongresit (Library of Congress Subject Headings)

1 – Përcaktuese lëndore e Bibliotekës së Kongresit e letërsisë për fëmijë (LC Subject Headings for children's literature)

2 – Përcaktuese lëndorë të mjekësisë (Medical Subject Headings)

3 – Përcaktuese lëndore nga lista autoriale e Bibliotekës Kombëtare të Bujqësisë (National Agricultural Library Subject Authority File)

4 – Burimi nuk specifikohet

5 – Përcaktuese lëndore kanadeze

6 – Répertoire de vedettes-matière

7 – Burimi i specifikuar në nënfushën \$2

(Vërejtje sa u përket përcaktueseve lëndore nga lista "Sears": Formati MARC 21 nuk ka ndonjë tregues të përcaktuar sa i përket kësaj liste. Prandaj, përdoret treguesi 7 si dhe kodi "sears" i cili është formë e përcaktuar në formatin MARC që vendoset në nënfushën \$2)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Emër personal (Mbiemri dhe emri)

\$b – Numërimi

\$c – Titujt dhe fjalët e tjera që kanë të bëjnë me emrin (R)

\$q – Formë më e plotë e emrit

\$d – Datat lidhur me emrin (zakonisht viti i lindjes)

\$t – Titulli i veprës

\$v – Formë e nënndarjes (R)

\$x – Nënndarje e përgjithshme (R)

\$y – Nënndarje kronologjike (R)

\$z – Nënndarje gjeografike (R)

\$2 – Burimi i përcaktueses apo termit (përdoret me treguesin e dytë në 7)

Shembull: 600 10 \$a Shakespeare, William,
\$d 1564-1616
\$x Comedies
\$x Stage history.

Shembull: 600 10 \$a Shakespeare, William,
\$d 1564-1616
\$x Knowledge
\$z Rome
\$v Congresses.

Vëni re se nënfushat \$v, \$x, dhe \$z në fushën 600 janë të përsëritshme. Nënfushat \$v, \$x, \$y, dhe \$z nuk ka nevojë të jenë të radhitura në mënyrë alfabetike. Ato radhiten sipas normës së sistemit të përcaktueseve lëndore.

610 – Përcaktuese shtesë lëndore – emër korporativ (R)

Treguesi 1: Lloji i elemteve të emrit korporativ

0 – Emër i renditur në mënyrë të anasjelltë (nuk përdoret me AACR2)

1 – Emër juridik

2 – Emri i renditur sipas paraqitjes

Treguesi 2: Sistemi/tezauri i përcaktue-

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

ses lëndore.

Shih treguesin 2 te fusha 600

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Element përcaktues i emrit korporativ ose i emrit juridik

Sb – Njësi e varur (R)

Sv – Formë e nënndarjes (R)

Sx – Nënndarje e përgjithshme (R)

Sy – Nënndarje kronologjike (R)

Sz – Nënndarje gjeografike (R)

\$2 – Burimi i përcaktueses apo termit (përdoret me treguesin e dytë në 7)

Shembull: 610 10 Sa United States. Sb Army Air Forces Sv Biography.

650 - Përcaktuese shtesë lëndore – Term tematik (Pjesa më e madhe e përcaktueseve lëndore përkojnë me këtë fushë.) (R)

Treguesi 1: Shkalla e përshkrimit lëndor

– Nuk jepen informacione

Treguesi 2: Sistemi/tezaurim i përcaktueses lëndore

(identifikon se prej cilës listë është marrë përcaktuesja)

0 – Përcaktuese lëndore e Bibliotekës së Kongresit (Library of Congress Subject Headings)

1 – Përcaktuese lëndore e Bibliotekës së Kongresit e letërsisë për fëmijë (LC Subject Headings for children's literature)

2 – Përcaktuese lëndorë të mjekësisë (Medical Subject Headings)

3 – Përcaktuese lëndore nga lista autoriale e Bibliotekës Kombëtare të Bujqësisë (National Agricultural Library Subject Authority File)

4 – Burimi nuk specifikohet

5 – Përcaktuese lëndore kanadeze

6 – Répertoire de vedettes-matière

7 – Burimi i specifikuar në nënfushën \$2

(Vërejtje sa u përket përcaktueseve lëndore nga lista "Sears": Formatu MARC 21 nuk ka ndonjë tregues të përcaktuar sa i përket kësaj liste. Prandaj, përdoret treguesi 7 si dhe kodi "sears" i cili është formë e përcaktuar në formatin MARC që vendoset në nënfushën \$2)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

Sa – Term tematik

Sv – Formë e nënndarjes (R)

Sx – Nënndarje e përgjithshme (R)

Sy – Nënndarje kronologjike (R)

Sz – Nënndarje gjeografike (R)

\$2 – Burimi i përcaktueses apo termit (përdoret me treguesin e dytë në 7)

Shembull: 650 #0 Sa Teatër Sz Kosovë Sv Biografi Sv Fjalor.
--

Vëni re se nënfushat Sv, Sx, dhe Sz në fushën 650 janë të përsëritshme. Nënfushat Sv, Sx, Sy, dhe Sz nuk ka nevojë të jenë të radhitura në mënyrë alfabetike. Ato radhiten sipas normës së sistemit të përcaktueseve lëndore.

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

651 - Përcaktuese shtesë lëndore – Emër gjeografik (R)

Treguesi 1: i papërcaktuar.

Treguesi 2: Sistemi/tezaurim i përcaktueses lëndore.

Shih treguesin 2 në fushën 600

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Emër gjeografik

\$v – Formë e nënndarjes (R)

\$x – Nënndarje e përgjithshme (R)

\$y – Nënndarje kronologjike (R)

\$z – Nënndarje gjeografike (R)

\$2 – Burimi i përcaktueses apo termit (përdoret me treguesin e dytë në 7)

Shembull: 651 #0 \$a Shtetet e Bashkuara \$x Histori \$v Kronologji.
--

Vëni re se nënfushat \$v, \$x, dhe \$z në fushën 651 janë të përsëritshme. Nënfushat \$v, \$x, \$y, dhe \$z nuk ka nevojë të jenë të radhitura në mënyrë alfabetike. Ato radhiten sipas normës së sistemit të përcaktuesëve lëndore.

700 - Përcaktuese shtesë – Emër personal (R)

Treguesi 1: Lloji i elementeve të emrit personal

0 – Emri

1 – Mbiemri (kjo është forma më e zakonshme)

3 – Emër familje

Treguesi 2: Lloji i përcaktueses shtesë.

– Nuk jepen informacione (zakonisht; bashkautorët, redaktorët, etj.)

2 – Përcaktuese analitike (Vlerat për treguesin 2 ndryshuan në vitin 1994, kur

u bë integrimi i formateve, kështu që njësitë bibliografike më të vjetra mund të shfaqin në sisteme vlera të tjera. Një përcaktuese analitike përfshin një autor/titullin e një njësie që gjendet në atë vepër.)

Nënfushat përdorura më së shpeshti:

\$a – Emër personal

\$b – Numërimi

\$c – Titujt dhe fjalët e tjera që kanë të bëjnë me atë emër (R)

\$q – Forma më e plotë e emrit

\$d – Data lidhur me emrin (zakonisht viti i lindjes)

\$e – Term lidhës (si ilustr.) (R)

\$4 – Kod lidhës (R)

Shembull: 700 1# \$a Baldrige, Letitia.

710 – Përcaktuese shtesë – Emër korporativ (R)

Treguesi 1: Lloji i elementeve të përcaktueses korporative

0 – Emër i renditur në mënyrë të anasjelltë (nuk përdoret me AACR2)

1 – Emër juridik

2 – Emri i renditur sipas paraqitjes

Treguesi 2: Lloji i përcaktueses shtesë.

Shih treguesin 2 te fusha 700

– Nuk jepen informacione

2 – Përcaktuese analitike

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Element përcaktues i emrit korporativ ose i emrit juridik

\$b – Njësi e varur (R)

Shembull: 710 2# \$a Sunburst Communications (Firm)
--

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

\740 - Përcaktuese shtesë – Titull analitik i pakontrolluar (R)

Treguesi 1: Karakteret që nuk indeksohen

0-9 – Numri i karaktereve të pranishme që nuk indeksohen (për nyjet në fillim të fjalës përfshirë edhe hapësirën ndërmjet elementeve)

Treguesi 2: Lloji i përcaktueses shtesë.

Shih treguesin 2 te fusha 700
– Nuk jepen informacione
2 – Përcaktuese analitike

(Kjo fushë u përcaktua sërish në vitin 1994, kur u bë integrimi i formatit. Para vitit 1994, kjo fushë përdorej edhe për tituj të ndryshëm, si titull i ndryshëm në shpinë të librit. Në njësitë bibliografike të krijuara që prej integritit të këtij formati, këta tituj të ndryshëm ndodhen në fushën 246.)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Titulli

Shembull: 740 02 \$a Uncle Vanya.

800 - Përcaktuese shtesë e serisë – emër personal (R)

Treguesi 1: Lloji i elementeve të emrit personal

0 – Emri
1 – Mbiemri
3 – Emër familje

Treguesi 2 i papërcaktuar.

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Emër personal
\$b – Numërimi
\$c – Titujt dhe fjalët e tjera që kanë të bëjnë me atë emër (R)
\$q – Forma më e plotë e emrit
\$d – Data lidhur me emrin

(zakonisht viti i lindjes)

\$t – Titulli i veprës (seritë)

\$v – Numri i vëllimit

Shembull: 800 1# \$a Fisher, Leonard Everett.
\$t Colonial American craftsmen.

830 - Përcaktuese shtesë e serisë – Titull uniform (R)

Treguesi 1 i papërcaktuar.

Treguesi 2: Karakteret që nuk indeksohen

0-9 – Numri i karaktereve të pranishme që nuk indeksohen (për nyjet në fillim të fjalës përfshirë edhe hapësirën ndërmjet elementeve)

Nënfushat e përdorura më së shpeshti:

\$a – Titull uniform

\$v – Numri i vëllimit

Shembull: 830 #0 \$a Railroads of America
(Macmillan)

=====
PJESA VIII

Listi e fushave të tjera të cilat i hasim shpesh në njësitë bibliografike në formatin MARC

- | | |
|-----|---|
| 001 | Numri i kontrollit |
| 003 | Identifikuesi i numrit të kontrollit |
| 005 | Data dhe koha e transaksionit të fundit |
| 006 | Fushë me gjatësi fikse të elementeve të informacionit – karakteristika shtesë të materialit |
| 007 | Fusha e përshkrimit fizik |
| 008 | Fushë me gjatësi fikse të elementeve të informacionit |

————— **Formati MARC** —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

(Shih pjesën X)		materialit – profesioni
022 Numri standard ndërkombëtar i periodikut (ISSN)	730	Përcaktuese shitesë – Titull uniform
037 Burimi i pasurimit	852	Lokacioni/vendndodhja
041 Kodi i gjuhës	856	Lokacioni elektronik dhe qasja elektronike
043 Kodi i hapësirës gjeografike	9XX	Të rezervuar për përdorim lokal. (Përdoren nga shitësit, sistemet, apo bibliotekat të veçanta për të shkëmbyer informacione shitesë)
050 Numri i klasifikimit të Bibliotekës së Kongresit		
080 Numri i klasifikimit - KUD		
082 Numri i klasifikimit sipas Dewy		
110 Përcaktuese kryesore – Emër korporativ (më pak i paraqitur sipas rregullave të AACR2)		
256 Karakteristika të fajlleve të kompjuterit		
263 Data e paraparë e botimit (tregon njësinë se është në CIP – Katalogim në botimin)		
306 Kohëzgjatja e materialit, film, muzikë, etj.		
508 Vërejtje falënderuese për krijimin/prodhimin		
510 Vërejtje citati/reference (burime kritikash)		
511 Vërejtje për pjesëmarrësin apo performuesin		
521 Vërejtje për cilën audiencë është krijuar (treguesi i parë: 0 = niveli i leximit, 1 = niveli i moshës, 2 = niveli i klasës, 3 = karakteristika të veçanta të audiencës, 4 = niveli me interes motivues)		
530 Vërejtje shitesë për formën fizike		
538 Vërejtje për hollësi të tjera teknike të materialit		
586 Vërejtje për çmimet e fituara		
656 Term kyç në përmbajtje të		

—————
PJESA IX

Numri udhëheqës

Numri udhëheqës përbëhet prej 24 pozitive, prej numrit 00 deri në 23. Për një shtjellim të plotë, shih librin *Formatin MARC21 për njësitë bibliografike* (ang: *MARC 21 Format for Bibliographic Data*.)

00-04 Gjatësia e njësisë bibliografike (kompjuteri e llogaritë gjatësinë e secilës njësi)

05 Statusi i njësisë

a = Shitesë në nivelin e kodimit

c = E korrigjuar apo e rishikuar

d = E fshirë

n = E re

p = Shitesë në nivelin e kodimit që para botimit (CIP-i i mëhershëm)

06 Lloji i njësisë bibliografike

a = Gjuha e materialit

c = Muzikë e shtypur

d = Muzikë dorëshkrim

e = Material kartografik

f = Material kartografik - dorëshkrim

g = Medium për projektor

————— Formati MARC —————
të kuptuarit e njësive bibliografike

- i = Incizime zanore jomuzikore
j = Incizime zanore muzikore
k = Grafikë jo për projektor dydimensionale
m = Fajll kompjuteri
o = Komplete.
Përmban një përzierje komponentësh të dy apo më shumë llojesh të njësive, asnjëra prej të cilave nuk është dominante në këtë komplet.
p = Materiale të përziera
r = Artefakte tredimensionale apo objekte natyrale ashtu siç janë
t = Gjuha e materialit në dorëshkrim
- 07 Niveli i përshkrimit bibliografik
a = Pjesë përbërëse monografike
b = Pjesë përbërëse e periodikut
c = Koleksion
d = Nënnyjësi
i = Burim i integruar
m = Monograf/njësi
s = Periodik/serial
- 08 Lloji i kontrollit
= Lloji i papërcaktuar
a = Arkivor
- 09 Skema e kodimit
= MARC-8
a = UCS/Unicode
- 10 Numri i kodeve të tregueseve (gjithmonë “2”)
- 11 Numri i kodeve të nënfushave (gjithmonë “2”)
- 12-16 Adresa bazë e informacionit (e llogaritur nga kompjuteri për secilën njësi bibliografike)
- 17 Niveli i kodimit
= Nivel i plotë
1 = Nivel i plotë, materiali nuk iu ka nënshtruar ekzaminimit
2 = Më pak se i plotë, materiali nuk iu ka nënshtruar ekzaminimit
3 = Nivel i shkurtuar
4 = Nivel thelbësor
5 = Nivel i pjesërishëm (preliminar)
7 = Nivel minimal
8 = Nivel i katalogimit në botim (CIP)
- u = Nuk dihet
z = Nuk aplikohet
- 18 Forma e përshkrimit bibliografik
= jo-ISBD
a = AACR2
i = ISBD
u = Nuk dihet
- 19 Kërkesat për lidhjen e njësive bibliografike
= Nuk kërkohet njësi lidhëse (për ta përpunuar në mënyrë të plotë këtë njësi bibliografike)
r = Kërkohet njësi lidhëse (për ta përpunuar në mënyrë të plotë këtë njësi)
